

Informacion kryesor për investitorin

Ky dokument përfshin informacionin kryesor për investitorin mbi Fondin Raiffeisen Miks. Dokumenti nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohet me Ligj, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe risqet që shoqërojnë investimin në fond. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo në këtë fond.

FONDI I INVESTIMIT RAIFFEISEN MIKS

Sipërmarrje Investimesh Kolektive me ofertë publike dhe me pjesëmarrje të hapur, administrohet nga Raiffeisen Invest – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.

Kuotat e Fondit nuk janë të siguruar nga skema e sigurimit të depozitave, investimi në fondin Raiffeisen Miks nuk është një investim i garantuar, fondi nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve, dhe risku i humbjes së principalit përballohet nga investitori.

➤ Objektivat dhe politika e investimit*

Objektivi i investimit të Fondit është krijimi i të ardhurave të rregullta dhe një rritje e moderuar e kapitalit në një periudhë afatmesme. Fondi synon një portofol miks dhe asetet e tij investohen në Tituj borxhi, Aksione, instrumente të Tregut të parasë dhe ekuivalentë cash-i. Fondi investon deri në 75% të totalit të aseteve në Tituj borxhi, të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, nga një vend i BE-së apo çdo shtet tjetër i miratuar nga rregullatori vendas, nga institucionet ndërkombëtare dhe / ose shoqëri tregtare. Këto tituj tregtohen në një treg të rregulluar ose bursë zyrtare në Republikën e Shqipërisë, në një vend të BE-së ose në një vend tjetër të lejuar nga AMF. Fondi investon deri në 40% të aseteve në aksione, të cilat mund të jenë në formën e titujve individuale që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në vende të zhvilluara/në zhvillim ose kuota të fondeve të investimit të tregtuara ose jo në burse. Politika e investimit synon kryesisht tituj të tregtuar në tregjet e zhvilluara në SH.B.A. dhe Europë. Fondi përcakton natyrën e investimeve të aseteve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Fondi menaxhohet pa ju referuar një standardi. Nëse do të përdoren instrumente financiare derivative, qëllimi do të jetë zbutja e risqeve dhe arritja e objektivave të politikës së investimit, por faktorë të tillë si likuiditeti i instrumentit tek i cili mbështetet derivativi dhe luhatshmëria e vlerës së tij mund të ndikojnë në performancën e fondit. Të ardhurat e fondit nuk shpërndahen por ri-investohen. Monedha bazë e Fondit është Euro. Investimet dhe shlyerjet bëhen në Euro. Shitja e kuotave të fondit mund të bëhet në çdo kohë nga ana e investitorit me kërkesë të tij, shlyerja e tyre bëhet brenda afatit ligjor prej 7 ditësh nga dita e mbërritjes së një kërkesë të vlefshme për shitje. Performanca e Fondit dhe rrjedhimisht edhe vlera e investimit mund të luhetet në varësi të kushteve të tregut. Luhajtja e normave të interesit të instrumenteve financiare në të cilat fondit investon dhe luhatshmëria që pësojnë tregjet e aksioneve janë faktorët kryesorë që ndikojnë në performancën e fondit. Kostot e transaksioneve nuk kanë një ndikim material mbi performancën e fondit.

Rekomandim: Fondi Raiffeisen Miks mund të mos jetë i përshtatshëm për investitorët të cilët planifikojnë të tërhiqen nga fondi brenda afatit 5 vjeçar. Duke patur parasysh natyrën e investimeve me luhatshmëri të lartë siç janë aksionet, ky horizont do të rriste mundësinë për një kthim optimal nga investimi. Fondi nuk duhet të përdoret si një llogari rrjedhëse, por si një mënyrë investimi afatmesme dhe afatgjatë pasi qëndrimi shumë i shkurtër në fond mund të rezultojë në një kthim të pakënaqshëm.

*Për më tepër informacion mbi objektivat e investimit jeni të lutur ti referoheni prospektit të Fondit Raiffeisen Miks.

➤ Profili i risk dhe përfitimit

Risk i ulët

Potencial Përfitimi më i ulët

Risk i lartë

Potencial Përfitimi më i lartë

1	2	3	4	5	6	7

- Treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit ka për qëllim ti japë investitorit një ide mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës. Treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë.
- Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.
- Kategoria e treguar e riskut nuk garantohet dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës.
- Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.
- Bazuar në rezultatin e aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit dhe të tregut të kapitalit për 5 vitet e fundit, profili i parashikuar i riskut të fondit i përket kategorisë 4 të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit (SRR=4).
- Fondi ka një profil risku mesatar dhe është subjekt i një luhatshmërie më të lartë se sa një fond i thjeshtë obligacionesh.

Risqe me rëndësi materiale të cilat nuk mbulohen tërësisht nga treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit:

Risku i kreditit: ky risk lidhet me mundësinë që emetuesi i një instrumenti financiar, pjesë e aseteve të Fondit, të mos jetë në gjendje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht detyrimet e tij, çka do të kishte një impakt negativ mbi vlerën e aseteve të Fondit. Edhe kur instrumentat e investimit zgjidhen me kujdesin dhe përgjegjshmërinë e duhur, është e pamundur që risku i kreditit të përjashtohet plotësisht.

Risku i likuiditetit: risku që një instrument financiar të mos shitet shpejt dhe me një çmim të përafërt me vlerën e tregut.

Risk i palës tjetër: risku që pagesa në një sistem transfertash të mos kryhet ose të kryhet me vonë. Gjithashtu ky risk lidhet me mundësinë që pala tjetër të mos jetë në gjendje të realizojë pagesat sipas kushteve të një marrëveshjeje apo transaksioni të paracaktuar.


Risku operacional: risku i humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabimet njerëzore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e marketingut, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit.

> Komisionet dhe tarifat

Komisionet dhe tarifat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit Raiffeisen Miks, duke përfshirë këtu kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave të fondit. Këto komisione dhe tarifa zvogëlojnë rritjen potenciale të investimit.

Komisione/tarifa të njëhershme përpara ose pas investimit	
Komisioni/tarifa e hyrjes	0.00%
Komisioni/tarifa e largimit	0.00%
Komisione/tarifa të vazhdueshme që mbahen gjatë 1 viti	1.57%
Shifra e tarifës së vazhdueshme mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2024. Tarifa e vazhdueshme përfshin tarifën e administrimit dhe çdo tarifë të vendosur gjatë vitit të kaluar. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifat e vazhdueshme që paguhen nga asetet e fondit në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë 3,5% në vit të vlerës neto të aseteve të fondit. Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit. Lutemi referojuni zërit "Shpenzime" të raportit vjetor të fondit për detaje të mëtejshme lidhur me komponentët e tarifës së vazhdueshme. Për më tepër informacion rreth kostove/tarifave, jeni të lutur ti referoheni seksionit 2.15 të prospektit të Fondit të publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë Administruese : www.raiffeisen-invest.al;	
Komisione/tarifa të veçanta	
Komisioni/tarifa e Performancës	E paaplikueshme

> Paraqitja e performancës së shkuar



Performanca e shkuar shërben vetëm për qëllime informative dhe nuk përfaqëson premtim apo garanci për performancën e fondit në të ardhmen. Performanca e treguar në grafik është kthimi neto i fondit, pasi është zbritur tarifa e vazhdueshme vjetore. Fondi ka filluar aktivitetin më 16 Nëntor 2020. Performanca e shkuar është e llogaritur në monedhën Euro.

> Informacione praktike

- Banka Depozitare është Banka e Parë e Investimeve sh.a.
- Kopje të prospektit dhe raporteve më të fundit të ecursisë së Fondit mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: www.raiffeisen-invest.al, si dhe pranë degëve të Raiffeisen Bank sh.a.
- Çmimi i kuotës së fondit publikohet çdo ditë në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: www.raiffeisen-invest.al, ku mund të gjeni informacion më të detajuar mbi fondin.
- Regjimi tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë aplikohet mbi të ardhurat e realizuara, të cilat rezultojnë nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave në fond.
- Raiffeisen INVEST sh.a. është përgjegjëse e vetme për çdo informacion/deklaratë të përfshirë në këtë dokument që është çorientues, i pasaktë ose në kundërshtim me pjesët përkatëse të prospektit të fondit.

Ky fond është i licencuar dhe rregullohet në Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Raiffeisen INVEST sh.a është e licencuar dhe rregullohet në Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Ky dokument me informacionin kryesor për investitorin është i saktë në datën e publikimit 20 Shkurt 2025.